




Nr. 11 plot
Shkodër, 12/03/18

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI KOMBËTAR I UJIT
KËSHILLI I BASENIT UJOR DRIN-BUNË



V E N D I M

Nr. 5 Datë 07.03.2018

“MIRATIM NË PARIM PËR PËRDORIM TË BURIMIT UJOR PËR ENERGJI ELEKTRIKE” SUBJEKTIT “TRADITA GEG & TOSK” SH.P.K.

Në mbështetje të nenit 7 pika 2 ,të nenit 50, pika 2,të ligjit nr 111/2012 dt.15.11.2012 “Për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore”,të VKM Nr.416 datë 13.05.2015 si dhe të nenit 24, pika1/ c, të VKM Nr. 822 datë 07.10.2015, “ Për miratimin e rregullave dhe procedurave të ndërtimit të kapaciteteve të reja prodhuese të energjisë elektrike, që nuk janë objekt konçesioni”, me propozim të A.B.U Drin- Bunë, miratimin në parim të Këshillit Konsultativ dhe oponentës së DPBU në ministrinë përgjegjëse për administrimin e burimeve ujore, pas shqyrtimit të dokumentacionit përkatës, Këshilli i Basenit Ujor Drin- Bunë,

V e n d o s i:

1-Miratimin në parim të kërkesës së subjektit **“TRADITA GEG & TOSK” SH.P.K.** me administrator Z. Sami Brahimi, për përdorim të burimit ujor, **Përroi i Abatit**, degë e Lumit të Shalës, për prodhim energjie elektrike në fshatin Abat, Njësia Administrative Shalë, Bashkia Shkodër, Qarku Shkodër .

Sipas studimit të paraqitur nga subjekti, HEC MAJA do të ketë këto të dhëna:

Koordinatat e veprës së marrjes : X - 44 01 973.68; Y - 46 87 602.17; Z - + 660 m;
Koordinatat e godinës së centralit: X - 44 00 934.88; Y - 46 86 785 58; Z - + 330 m;
Koordinatat e pikes së shkarkimit : X - 44 00 934.88; Y - 46 86 785 58; Z - + 330 m;

Prurja mesatare e përroit: Qmes = 0.594 m³/sek;

Sasia e ujit që kërkohet të përdoret nga subjekti: Q llog = 0.600 m³/sek;

Prurja ekologjike: Q ekol = 0.07 m³/sek;

Prurja që shkarkohet: Q= 0.600 m³/sek.

2- Autorizimi (miratimi në parim) i përdorimit të burimit ujore për prodhim energjie elektrike jepet me kusht që të mos kufizohet furnizimi me ujë të pijshëm, nevojat e bujqësisë në zonë dhe rezerva e domosdoshme ekologjike.

3- Ngarkohet A.B.U. Drin-Bunë për zbatimin e këtij vendimi.

PËR KËSHILLIN E BASENIT UJOR DRIN-BUNË

SEKRETAR

Raimonda GURI



KRYETAR

Çesk MILLJA

